

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË
TIRANË
Nr.Rep. 4261
Nr.Kol. _____

Tiranë, më 16/6/2003

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datën 16/6/ 2003, para meje FATMIR LACES, Noter në Dhomën e Noterisë Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme:

• **Shitës:** Z. Taulant Kadiu, i biri i Menduhit, lindur më 1976, në Lushnje dhe banues në Tiranë, Rr. "Sami Frashëri", Pall. I ri pas Kinema Agimit, kati 9, Nr. 23, me shtetësi shqiptare, me Nr. pasaporte: 0066274, që më poshtë në këtë kontratë do të quhet "**Shitësi**" dhe,

• **Blerësa:**

1. Z. Adulkadir Kazaca, i biri i Burhanettinit, lindur më 1948, në Istambul, të Turqisë dhe banues në adresën: Acibadem caddessi No. 125/7 Uskudar/Istambul, me Nr. Pasaporte TR-N 722834,
2. Z. Sadik Sadikoglu, i biri i Omerit, lindur më 1953, në Tetova, dhe banues Turqi në adresën: Osmanaga mah. Yasa cd. No. 28, Kadikoy/Istambul, me Nr. Pasaporte TR-H 65482,
3. Z. Selim Senocak, i biri i Cevatit, lindur më 1961, në Istambul, të Turqisë dhe banues në adresën: Acibadem caddessi No. 14/6, Uskudar/Istambul, me Nr. Pasaporte TR-D 238352,
4. Z. Davut Hancioglu, i biri i Sabanit, lindur më 1965, në Gostivar dhe banues në Turqi në adresën: Guzeltepe mah. Bosna Blvr, No. 125, Uskudar/Istambul, me Nr. Pasaporte TR-M 304104, që më poshtë në këtë kontratë do të quhen "**Blerësit**",

madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët, me vullnetin e tyre të lirë dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar, lidhin këtë kontratë shitje bazuar në Ligjin "Për shoqëritë tregtare" 7638, datë 19.11.1992.

Objekti i kontratës: është kalimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotat, në masën 40% (dyzetë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k, që zotëron **Shitësi** si ortak i kësaj shoqërie, me seli në Tiranë, Rr. "E Elbasanit",

(Tërë vëllezërit e Kombit") në favor të **Blerësave** në pjesë të barabarta nga 10 % (dhjetë për qind) secili prej tyre.

Bazuar në Vendimin e regjistrimit si person juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 25843, datë 21.05.2001, ndryshuar me vendimin Nr. 25843/2, datë 20.01.2003, në Statutin dhe në Aktin e themelimit të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k, **Shitësi** është ortak i kësaj shoqërie dhe zotëron 40% të kapitalit të saj themeltar.

Meqënëse Ortakët e tjerë nuk kanë pasur interes dhe janë shprehur në vendimin e Asamblesë së ortakëve Nr. 2, datë 16.06. 2003 se janë dakort me shitjen e kuotave në favor të **Blerësave**, atëherë palët në këtë kontratë bien dakort që pronësia mbi 40% të kuotave mbi kapitalin themeltar të kalojë në favor të **Blerësave** në pjesë të barabarta nga 10 % (dhjetë për qind) secili prej tyre kundrejt cmimit prej 2 500 \$ (dy mijë e pesëqind dollarë amerikan) secili prej **Blerësave**.

Me legalizimin e kësaj kontrate, **Blerësit** bëhen pronar mbi 10% (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k secili dhe **Shitësi** zhvishet nga e drejta e tij për të kaluar pronësinë mbi kuotat e mësipërme në favor të ndonjë personi tjetër.

Cmimi i shitjes është 10 000 USD (dhjetë mijë dollarë amerikan), për gjithë kuotat që zotëron **Shitësi** në masën 40% të kapitalit të shoqërisë, pra, 2 500 \$ (dy mijë e pesëqind dollarë amerikan) për secilin nga **Blerësat** dhe është likujduar plotësisht nga palët jashtë Zyrës së Noterisë.

Në Zyrën e Noterisë u paraqitën edhe dy ortakët e tjerë Rahmi TOZDUMAN dhe Avni ERTANSEL, të cilët deklaruan se ishin plotësisht dakort me shitjen e 40% të kuotave nga kapitali themeltar në favor të **Blerësave**.

Palët në këtë kontratë, mbasi e lexuan dhe e kuptuan plotësisht përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë, para meje noteres. Prandaj edhe unë noteri, e vërtetoj atë sipas ligjës.

Kjo kontratë hartohet në katër kopje. Vendimi i Gjykatës, Nr 25843, datë 21.05.2003, Statuti, Akti i themelimit dhe Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të datës, 2003 i bashkëngjiten kontratës në çdo kopje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Pala Shitëse

FATMIR LACI

Fatmir Laci

SELIM SENOLAK

Selim Senolak

NOTER

FATMIR LACI

Fatmir Laci

Pala Blerëse

SADIK SADIQOGLU

Sadik Sadıqoğlu

DAVUT HANCIĞLU

Davut Hancıoğlu

ABDÜLKADİR KAZACA

Abdülkadir Kazaca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË
TIRANË
Nr.Rep. 4260
Nr.Kol. _____

Tiranë, më 16.6.2003

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datën 16/6/ 2003, para meje FATMIR LACE, Noter në Dhomën e Noterisë Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Shitës:** Z. Avni ERTANSEL, i biri i M.AR., lindur më 1936, në Mardin, të Turqisë dhe banues në adresën: Dr. Komal Akgudar, Cad. 50/14, Boutara, Istanbul, me shtetësi turke, me Nr. Pasaporte TR-A 004388, që më poshtë në këtë kontratë do të quhet , që më poshtë në këtë kontratë do të quhet "**Shitësi**" dhe,
- **Blerës:** Z. Hayrettin Ozkul, i biri i Ali Nurettinit, lindur më 1966, në Tavsanli, të Turqisë dhe banues në Turqi në adresën: Samarsik sok. Gul. Apt.no:17/3 B. Evler/Istanbul, me Nr. Pasaporte TR-K 757068, që më poshtë në këtë kontratë do të quhet "**Blerësi**",

madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët, me vullnetin e tyre të lirë dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar, lidhin këtë kontratë shitje bazuar në Ligjin "Për shoqëritë tregtare" 7638, datë 19.11.1992.

Objekti i kontratës: është kalimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotat, në masën 20% (njëzetë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k, nga pjesa prej 40% (dyzetë për qind), që zotëron **Shitësi** si ortak i kësaj shoqërie, me seli në Tiranë, Rr. "E Elbasanit", ("Tre vëllezërit e Kombit").

Bazuar në Vendimin e regjistrimit si person juridik te Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 25843, datë 21.05.2001, në vendimin Nr. 25843/2, datë 20.02.2003, në Statutin dhe në Aktin e themelimit të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k, **Shitësi** është ortak i kësaj shoqërie dhe zotëron 40% të kapitalit të saj themeltar dhe me anë të kësaj kontrate gjysmën e kutave të tij në masën 20% (njëzetë për qind) ia kalon blerësit.

Meqënëse Ortakët e tjerë nuk kanë pasur interes dhe janë shprehur në vendimin e Asamblesë së ortakëve Nr. 3, datë 16.06.2003 se janë dakort me shitjen e kuotave në favor të Blerësit, atëherë palët në këtë kontratë bien dakort që pronësia mbi 20% të kuotave mbi kapitalin themeltar të kalojë në favor të **Blerësit** kundrejt cmimit prej 5 000 \$, (pesë mijë dollarë amerikan).

Me legalizimin e kësaj kontrate, **Blerësi** bëhet pronar mbi 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company", sh.p.k dhe **Shitësi** mbetet pronar vetëm mbi 20% të kapitalit të shoqërisë, duke u zhvishur nga e drejta e tij për të kaluar pronësinë mbi masën 20% të kuotave të mësipërme në favor të ndonjë personi tjetër, për shkak se ato me anë të kësaj kontrate i kalojnë **Blerësit**.

Cmimi i shitjes është 5 000 USD, (pesë mijë dollarë amerikan) dhe është likuajduar plotësisht nga palët jashtë Zyrës së Noterisë.

Në Zyrën e Noterisë u paraqitën edhe dy ortakët e tjerë Rahmi Tozduman dhe Taulant KADIU, të cilët deklaruan se ishin plotësisht dakort me shitjen e 20% të kuotave nga kapitali themeltar në favor të **Blerësit**.

Palët në këtë kontratë, mbasi e lexuan dhe e kuptuan plotësisht përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë, para meje noteres. Prandaj edhe unë noteri, e vërtetoj atë sipas ligjës.

Kjo kontratë hartohet në katër kopje. Vendimi i Gjykatës, Nr 25843, datë 21.05.2003, Statuti, Akti i themelimit dhe Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të datës, _____ 2003 i bashkëngjiten kontratës në çdo kopje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Pala Shitëse

AVNI ERTANSEL

Pala Blerëse

Hayrettin Ozkul

NOTER

FATMIR LAÇEJ

